



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1162/15 Prot.

Patos, më 15/05/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 12 MAJ 2026

Vendi: Pranë qedres shëndetësore Siqecë

Ora e fillimit: 11:30

Ora e mbarimit: 12:30

Dëgjesë publike me temë: “Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin Paketa e Maleve”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1162 prot, datë 01.04.2026 të drejtorisë së Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile për zhvillimin e dëgjesës publike me temë: Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin në “Paketën e Maleve”.

Pjesëmarrës: Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj, Kryetar i Bashkisë Patos, z. Fation Duro, Zv/ Kryetar znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Juella Shpata, Drejtore znj. Boreta Murati etj., me pjesëmarrjen e *19 pjesëmarrësve (banorë, kryetar i fshatit Siqecë, përfaqësues të bashkisë Patos etj)*

Kryetar i Bashkisë, z. Fation Duro— Përhëndetje të gjithëve! Qëllimi i këtij takimi është të



**Kryetar i Bashkisë
z. Fation Duro
Dëgjesë publike me temë:**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

informojmë mbi Paketën e Maleve dhe ju të shprehni interesin mbi këtë proces. Zona prioritare në Patos do të jenë të shtrira në komplet njësinë administrative Ruzhdie, Kuqarin. Në pjesën e dytë mund të shtohet dhe Rrerësi me Rusinjën. Ideja e Paketës së Maleve është që personat që janë posedues të tokës, por jo pronarë dhe që kanë marrë një tokë për ta zhvilluar në kuadër të turizmit mund të aplikoj në Paketën e Maleve dhe do të mund të kenë një mënyrë për ta zhvilluar me hapa shumë të shpejt. Kjo është një nismë e qeverisë që nga viti 2025. Kjo është një mënyrë që për ata persona që kanë një tokë që e posedojnë për më shumë se 10 vjet, të kenë mundësi për ta zhvilluar dhe përfituar tokën. 500 përfituesit e parë janë të përjashtuar nga taksat. Nqse do të ketë pretendime nga dikush kur të fillojnë procedurat për të qënë pjese e Paketës së Maleve mbas miratimit të zonave prioritare, bëhet kërkesa, mës pas shqyrtohet nga bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Më pas hartohet Plani i investimeve nga personat që do përdorin këtë tokë, del leja përkatëse në Ministri dhe më pas dokumentacioni paraqitet për të bërë blerjen e tokës me vlerën prej 1 lekë. ASHK në momentin e miratimit të zonës prioritare në secilën bashki, fillon regjistrimin fillestar me procedura të përshpejtuara. Rishikohet dhe njëher harta dhe vazhdon procedura. Pra edhe njëherë kjo bëhet vetëm për toka që janë shtet dhe personi është posedues për një periudhë jo më pak se 10 vjet. Kjo vërtetohet nëpërmjet faturave tatimore, ortofotot e ndryshme që tregojnë zhvillimin e zonës, dhe mënyrave të tjera që tregojnë që kjo tokë ka qënë në përdorim të personit që aplikon. Duhet edhe vërtetim nga kryeplaku i zonës. Kjo pronë qëndron e afishuar rreth 45 ditë dhe nëse ka pretendime të tjera për atë tokë vendosen në dijeni. Nuk e di nëse ka ndonjë të interesuar në zonën tuaj? Bëhet një aplikim në E Albania me një plan rievimi dhe një plan biznesi çfarë do zhvillosh te ajo tokë. Më pas shqyrtohet aplikimi. Pas miratimit përfundimtar ajo tokë bëhet me certifikatë pronësie. Kryesore është zhvillimi i zonës. Në momentin që miratohen zonat prioritare, fillon regjistrimi fillestar i të gjithë tokave. Leja e ndërtimit merret edhe pse për shkak të Planit Vendor nuk lejohet. Procedurat janë më të përshpejtuara për Paketën e Maleve. Nëse ka ndonjë pyetje për procedurat apo të interesuar mund të shprehni interesin tuaj.

Banor i Siqecës, z. Xhevair Mesutaj– Përshëndetje! Unë kam një tokë në Siqec që e përdor.



Banor i Siqecës
z. Xhevair Mesutaj
Dëgjues publik me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”

Maj 2026

Si të aplikoj unë? A janë hapur aplikimet për Paketën e Maleve? Çfarë mund të aplikoj unë në Paketën e Maleve, a e përdor dot për bagëti?

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Ti aplikon me dokumentat që përmendëm dhe më lart, gjithmonë duke qënë posedues jopronarë i saj. Kjo tokë miratohet nga Këshilli Bashkiak, bëhet afishimi 45 ditor për të parë nëse ka pretendentë të tjerë. Pra nuk është një procedurë e thjeshtë, por për Paketën e Maleve ndiqet në mënyrë të përshpejtuar. Mund të aplikosh në cilën fushë të duash, nuk je i kufizuar vetëm në një fushë aktiviteti. Aplikimin do të mund ta bësh pasi të miratohen zonat priotiare.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Banor i Siqecës, z. Refat Buzi- Unë kam marrë tokë nga ligji, por kam zënë edhe disa dynym të tjerë. Si të veprojmë unë, si të aplikojmë?



**Banor i Siqecës
z. Refat Buzi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Për pjesën që ke zënë pa ta dhënë ligji 7501, ti



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

mund të aplikosh në Paketën e Maleve me një plan biznesi dhe të ndjekësh procedurën në mënyrë që ta zhvillosh tokën dhe në fund ta përfitosh me dokument pronësie. Gjithashtu do filloj dhe azhurnimi i zonës tuaj nga ASHK.

Banor i Siqecës, z. Gëzim Nebiaj– Marrim një shembull dhe supozojmë se një tokë e ka zënë një person. Kjo është tokë e imja me dokumentacion, por ma ka zënë ai person. A aplikon dot ai person në Paketën e Maleve?



**Banor i Siqecës
z. Gëzim Nebiaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Jo nuk aplikon dot në Paketën e Maleve sepse e posedon dikush atë tokë. Duhet të jesh posedues jopronarë pa dokumentacion. Duhet që ta përdorësh tokën dhe mos të ketë pretendime nga të tjerë.




**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj- Meqë jemi mbledhur, çfarë do bëhet me këto rrugët tona në Siqecë. Kjo rruga kryesore është bërë shumë keq, duhet ndërhyrë. Po traktori kur do vij nga zona jonë?




**Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj**

**Dëgjësë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i bashkisë Patos, Z. Fation Duro- Rruga kryesore është shumë e ngushtë dhe për momentin nuk ndërhyjmë dot sepse nuk futet dot makina që ta shtroj me çakull. Traktori për parcelat do filloj së shpejti.

Banor i Siqecës, z. Baftjar Saliaj- Kemi 50 m rrugë në lagje që duhet shtruar. Është rrug që shtroi Sadiku dhe ka lënë 50 m vetëm pa shtruar.



**Banor i Siqecës,
z. Baftjar Saliaj**

**Dëgjësë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- Pëshëndetje! Unë kam një pyetje lidhur me Paketën e Maleve. Çfarë parashikohet për aplikim dhe si mund ta përfitojmë tokën? Në momentin që janë më shumë se 1 pretendues, kush e përfiton tokën? Supozojmë se dikush ka një AMTP toke, por jo konform ligjit, që do të thotë se e ka përfutur tokën bujqësore në bazë të ligjit 7501, por jo në sipërfaqen e duhur që parashikonte ligji për frym. Në këtë rast si veprohet? Pra në atë kohë është përcaktuar norma për fryme, por nuk është llogaritur dhe ndarë në AMTP sipas normës. A quhet kjo AMTP e ligjshme.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Dokumentacionet verifikohen të gjitha në bazë të ligjit në fuqi. Norma për frymë nuk është e shkruar, por e llogaritur në bazë të komisionit që ka qënë i ngritur. Në atë kohë kush kishte interes merrte tokën. Ka pasur komisione të ngritura për ndarjen e tokave. Gjatë aplikimit për Paketën e Maleve të gjitha dokumentacionet do të verifikohen nga ana juridike.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba